

VENDIM
Nr. 53, datë 2.4.2024

**MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“GLOBAL TECHNICAL MECHANICS” SHPK, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË
E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “d”, 5, pika 1, germa “d” dhe 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 2.4.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 809/1 prot., datë 29.3.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Global Technical Mechanics’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Global Technical Mechanics” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 809, datë 21.3.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Nga ky aplikim rezulton se shoqëria nuk ka kryer pagesën e aplikimit për llogari të ERE-s, sipas përcaktimeve të aneksit A të Rregullores, dokumentacion i cili konsiderohet thelbësor, ndaj vlerësohet mosfillimi i procedurës për këtë aplikim.

- Në mbështetje të parashikimit të nenit 10 pika 7 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nëse aplikuesi, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijeni e vendimit për mosfillimin e procedurës, paraqet dokumentacionin thelbësor të konstatuar të munguar, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Global Technical Mechanics” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Aplikuesi mund të paraqesë pagesën e aplikimit për llogari të ERE-s, sipas përcaktimeve të Aneksit A të Rregullores, brenda 1 (një) muaji nga marrja e vendimit të bordit të ERE-s dhe dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm do të konsiderohet i vlefshëm edhe për aplikimin e ri.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Erjola Sadushi